



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1832/1 Prot.

Tiranë, më 27.12.2017

VENDIM

Nr.241, datë 27.12.2017

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 171, DATË 19.07.2017,
NË INSTITUCIONIN E DREJTORISË SË SIGURIMIT TË INFORMACIONIT
TË KLASIFIKUAR**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 171, datë 19.07.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nga punonjësi *****, protokolluar me kërkesat nr.519 prot., datë 08.08.2016 dhe nr. 519/8, datë 14.10.2016”, në institucionin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar,

KONSTATOVA SE:

Me Urdhrin nr.519/1 prot., datë 05.09.2016, të Komisionerit, “Për verifikimin e informacionit të ardhur nga *****, në lidhje me procedurën e konfirmimit si nëpunës civil”, si dhe me Urdhrin nr. 627 prot., datë 21.10.2016, të Komisionerit, “Për verifikimin e informacionit, në lidhje me lirimin nga shërbimi civil të punonjësit *****”, është nisur verifikimi i këtij rasti. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 171, datë 19.07.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nga punonjësi *****, protokolluar me kërkesat nr. 519 prot., datë 08.08.2016 dhe nr. 519/8 prot., datë 14.10.2016”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

1. Të kërkoj nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, të përmbyllë procesin e konfirmimit si nëpunës civil të nëpunësit *****, në përputhje me kërkesat e nenit 24, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të

ndryshuar dhe pikës 6, e në vijim, të Kreut VI, të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, duke vepruar në këtë mënyrë:

- ✓ Eprori direkt i pozicionit “Specialist Jurist, në Sektorin Juridik dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare”, të finalizojë periudhën e provës, me nxjerrjen e aktit individual përkatës të konfirmimit si nëpunës civil për punonjësin *****, duke marrë për bazë vlerësimin e punës të kryer nga Drejtori i DSIK, sipas përcaktimeve të pikave 6, 7 dhe 10, të Kreut VI, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.*
 - ✓ Vendimi i eprorit direkt, duhet t’i njoftohet nëpunësit ***** dhe njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike.*
 - ✓ Departamenti i Administratës Publike, në kuptim të pikës 13, të kreut VI, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, në rastin e vendimit të konfirmimit, duhet të finalizojë këtë proces nëpërmjet nxjerrjes së aktit të deklarimit të statusit të nëpunësit ***** brenda 10 ditëve, nga data e njoftimit të konfirmimit nga institucioni, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe të realizojë shënimin përkatës në Regjistrin Qendror të Personelit.*
- 2. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtori i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, eprori direkt i nëpunësit ***** Departamenti i Administratës Publike, njësia e burimeve njerëzore e institucionit, si dhe nëpunësi *****.*
 - 3. Për kryerjen e detyrave të përcaktuara më sipër institucionit i lihet afat 15 ditë.*
 - 4. Me kalimin e këtij afati, duhet të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mënyrën e zbatimit të vendimit.*

Me kalimin e afatit procedural të lënë për zbatimin e rekomandimeve të Vendimit Nr. 171, datë 19.07.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nga punonjësi *****, protokolluar me kërkesat nr. 519 prot., datë 08.08.2016 dhe nr. 519/8 prot., datë 14.10.2016”, të Komisionerit, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr. 1911 prot., datë 18.08.2017, “Mbi zbatimin e Vendimit tuaj nr. 171, atë 19.09.2017”, ka informuar Komisionerin për zbatimin e këtij vendimi, duke bashkëngjitur edhe praktikën shkresore që materializon zbatimin e tij.

Pas verifikimit të dokumentacionit bashkëngjitur shkresës së mësipërme të DSIK, rezultoi se, në pikën 1 të Vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga

institucioni i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, që të përmbyllë procesin e konfirmimit si nëpunës civil të nëpunësit *****.

Në përputhje me kërkesat e nenit 24 pika 3 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe pikës 6, e në vijim, të Kreut VI, të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, Drejtori i Financës, Shërbimeve Mbështetëse dhe Mbikëqyrjes Shtetërore ***** , i cili paraqitet në cilësinë e eprorit direkt për nëpunësin ***** , me detyrë “*Specialist Jurist, në Sektorin Juridik dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare*”, pranë kësaj drejtorie, ka finalizuar periudhën e provës me nxjerrjen e aktit individual të konfirmimit si nëpunës civil. Konkretisht, me Vendimin Nr. 2132, datë 17.08.2017, “Për konfirmimin si nëpunës civil të *****”, ***** ka vendosur konfirmimin si nëpunës civil të punonjësit *****.

Me shkresën nr. 1910 prot., datë 18.08.2017, “Mbi zbatimin e Vendimit të KMSHC nr. 171, datë 19.07.2017”, vendimi i konfirmimit i eprorit direkt i është dërguar Departamentit të Administratës Civile, i cili me aktin nr. 5155/1 prot., datë 26.09.2017, e ka deklaruar ***** , nëpunës civil, në pozicionin “*Specialist në Sektorin Juridik dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, në Drejtorinë e Financës, Shërbimeve Mbështetëse dhe Mbikëqyrjes Shtetërore*”.

Për sa u parashtua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrës së lënë në Vendimin Nr. 171, datë 19.07.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nga punonjësi ***** , protokolluar me kërkesat nr. 519 prot., datë 8.8.2016 dhe nr. 519/8 prot., datë 14.10.2016”, të Komisionerit, rezulton se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar janë zbatuar plotësisht të gjitha rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 171, datë 19.07.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nga punonjësi ***** , protokolluar me kërkesat nr. 519 prot., datë 8.8.2016 dhe nr. 519/8 prot., datë 14.10.2016”, në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 171 datë 19.07.2017.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha